




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 18.02.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 117/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankeses të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për ri-shqyrtim të datës 15.02.2021, të parashtruar nga OE PARTNERS SHPK & AGE GROUP SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material ndërtimor për ndërtimin-renovimin e shtëpive të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian”, me Nr. të Prok: 632-20-4704-1-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohen** si të pabazuara Kërkesat për ri-shqyrtim e OE PARTNERS SHPK & AGE GROUP SHPK të datës 09.02.2021, lidhur me aktivitetin e “Furnizim me material ndërtimor për ndërtimin-renovimin e shtëpive të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian”, me Nr. të Prok: 632-20-4704-1-2-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të AK –së, të datës 08.02.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.

2. **Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë 08.02.2021;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

OE PARTNERS SHPK & AGE GROUP SHPK me datë 15.02.2021, kanë parashtruar Kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material ndërtimor për ndërtimin-renovimin e shtëpive të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian”, me Nr. të Prok: 632-20-4704-1-2-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 16.02.2021, ka shqyrtuar Kërkesën në fjalë si më poshtë:

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se është bërë e padrejtë se nuk janë marrë për bazë dëshmitë e ofruara sipas kërkesës përmes letrës standarde për sqarim të tenderit, AK sqaron se sipas Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët ka kërkuar sqarime tek OE mirëpo sqarimet nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe sipas nenit 4.6.2 të kësaj rregulloreje “Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, ne përputhje me nenin 61 te LPP”.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se për 6 artikuj nuk kanë ofruar cmime më të larta se sa cmimet e tregut, AK sqaron se për këta artikuj ka bërë hulumtim të tregut dhe cmimet e tregut janë si në vijim:

Pershkrimi i artikullit	Cmimi i OE ankues	Cmimi i tregut 1	Cmimi i tregut 2	Cmimi i tregut 3	Cmimi i tregut 4	Cmimi i tregut 5	Cmimi i tregut 6	Cmimi i tregut 7
Bllok gjysmëgiter 19cm x 19cm x 25cm/ ose te ngjajshem	0.55	0.24	0.23	0.26	0.26	0.24		
Bllok gjysmëgiter 12cm x 20cm x 25cm/ ose te ngjajshem	0.48	0.23	0.20	0.24	0.24	0.23		
Armaturo Ø6 12m'	3.50	2.5	2	2.80	2.80	2.50		
Armaturo Ø12 12m'	7.45	7.2	7.20	7.70	6.95	7.50		
Tjegulla prej argjile te pjekura kuyalitetit te larte" Cakto TIPIN dhe sa copë/m ²	0.95	0.47	0.74	0.78	0.85	0.78		
Kabell ajrore 4x16 mm	2.20						0.90	1.00

Cmimi për artikullin “Armaturore Ø12 12m” i dhënë nga kompanitë e kontaktuar është i dhënë sipas cmimit të berzës që sipas tyre ka një rritje në treg andaj rezultojnë se është pothuajse i njëjtë sikurse në kohën e marrjes së cmimeve që është shumë lehtë e vërtetueshme në treg.

Pra, sic mund të shihet nga tabela më sipër, për këta artikuj OE ankues ka ofruar cmime më të larta se sa cmimet e tregut.

Tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se cmimi juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve nga publikimi i Vendimit në platformën elektronike <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>


Eaton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Grupi i OE Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës